VENDIM
Nr.13, datë 7.1.2009

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2009, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË KURIMIT, NË FINLANDË, TË Z.BUJAR NISHANI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 12 të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 "Për buxhetin e vitit 2009", me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2009, zëri "Shpenzime operative", t'i shtohet fondi 2 000 000 (dy milionë) lekë, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit, në Finlandë, të z.Bujar Nishani.

2.Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3.Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale.

4.Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha